


ZYRA E RREGULATORIT PËR ENERGJI
ENERGY REGULATORY OFFICE
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA, REPUBLIC OF KOSOVO Qeveria e Kosovës / Vlada Kosova / Government of Kosovo Ministria e Ekonomisë dhe Financave / Ministarstvo Privrede i Financija Ministry of Economy and Finance Zyra e Ministrit - Kancelaria Ministra - Office of the Minister	
Njësia Org. Org. Jedin Org. Unit	ZM
Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No.	216
Nr. i faqeve Broj stranica No. pages:	
Data Datum Date:	05.03.2010
PRISHTINË/A	

Nr. 057110
Data 12.03.2010 ADM, AN

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVO/ REPUBLIC OF KOSOVO

QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVO

MINISTRIA PËR EKONOMI DHE FINANCA
MINISTARSTVO ZA PRIVREDU I FINANCIJE
MINISTRY OF ECONOMY AND FINANCE

5 Mars, 2010

z. Ali Hamiti
Kryesues i Bordit
Zyra e Rregulatorit të Energjisë
Prishtinë, Republika e Kosovës

I nderuari Z. Hamiti,
I dashur Profesor Ali,

Së pari më lejoni që të shpreh kënaqësinë time të sinqertë për takimin që zhvilluam së bashku në zyrën time ku kishim rastin që të bisedojmë rreth qëndrueshmërisë së sektorit të energjisë në vendin tonë dhe bashkërendimit të aktiviteteve tona në mënyrë që të sigurojmë dhe arrijmë qëllimet e përbashkëta.

Po ashtu, me shumë interesim kam lexuar Raportin Konsultativ për Shqyrtimin e Katërt të Tarifave të Energjisë Elektrike 2010 duke u kushtuar vëmendje të posaçme konkluzioneve të ZRRE-së duke pasur parasysh faktin se këto konkluzione – në rast zbatimi - kanë një ndikim të madh në qëndrueshmërinë fiskale të Kosovës dhe të ndërmarrjeve publike, posaçërisht të atyre ndërmarrjeve publike që veprojnë në sektorin e energjisë.

Sikur që jeni të informuar, Strategjia e Qeverisë së Kosovës për sektorin e energjisë synon të arrijë përmirësime të konsiderueshme në cilësinë dhe sigurinë e shërbimeve për konsumatorët. Një ndër synimet kryesore të Qeverisë së Kosovës është rritja e qëndrueshme ekonomike dhe shtimi i konkurrueshmërisë. Për të arritur këto objektiva nevojitet kohë e konsiderueshme dhe qëndrueshmëri financiare e ndërmarrjeve që i ofrojnë këto shërbime.

Në vazhden e këtij angazhimi dhe programi, një nga synimet e Qeverisë sonë e cila është reflektuar po ashtu edhe në Strategjinë e Energjisë, është zvogëlimi maksimal i mundshëm i subvencioneve për ndërmarrjet publike dhe eliminimi i tërësishëm i tyre.

Ky objektiv është edhe një nga kërkesat kryesore të Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN) dhe donatorëve tanë ndërkombëtar. Andaj, është qëllimi i Qeverisë që të zvogëloj ndarjet buxhetore për importin e energjisë për vitin 2010 nga €40 milion në €30 milion. Ky trend i

uljes së subvencioneve do të vazhdojë edhe në vitet e ardhshme duke planifikuar që subvencioneve të eliminohen deri në vitin 2013. Nga kjo që u tha, është mëse e qartë se deri në vitin 2013, tarifat për konsumatorët e energjisë duhet të ndryshojnë në mënyrë që të reflektojnë koston reale të shërbimit me energji elektrike dhe ngritjen e cilësisë së shërbimeve të ofruara.

Pa marrë parasysh nëse bëhet apo jo privatizimi i sektorit të energjisë, janë shumë faktorë që do të imponojnë nevojën për ndryshimin e çmimeve të energjisë elektrike në Kosovë gjatë viteve të ardhshme, në këtë rast tarifave. Disa ndër faktorët kryesor janë: nevoja për rehabilitimin dhe riparimin e aseteve të rrënuara dhe joadekuata të gjenerimit dhe të distribucionit, zhvillimi i vazhdueshëm i aseteve të minierave, ndërtimi i kapaciteteve të reja prodhuese si dhe integrimi me tregun rajonal.


Për të shmangur tronditjet në çmime në të ardhmen që do të mund të shkaktonin vështirësi të shumta në disa aspekte e fusha, veçmas për konsumatorët e vegjël dhe kategoritë sociale me të ardhura më të ulëta, rekomandojmë që ZRRE të shqyrtojë mënyra që do të mundësonin ndryshime graduale të çmimeve dhe tarifave për energjinë elektrike.

Për këtë qëllim, Ministria e Ekonomisë dhe Financave sugjeron që duke nisur nga viti 2010, të lejohen të ndryshohen tarifat nga ana e ZRRE-së paralelisht me zvogëlimin e subvencioneve për sektorin e energjisë.

Ministria e Ekonomisë dhe Financave së bashku me Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Social dhe me institucionet e tjera relevante do të punojnë për të minimizuar efektin që ngritja e mundshme e tarifave mund të ketë në konsumatorët që gjenden në vështirë sociale.

Ministria e Ekonomisë dhe Financave mbetet e përkushtuar që në bashkëpunim të ngushtë me Ju dhe të gjitha ministritë tjera relevante Ministrinë tuaj të punojë në implementimin e këtyre politikave që do të mundësojnë qëndrueshmëri financiare për vendin tonë dhe shërbime më të mira për qytetarët duke siguruar kështu zhvillim, prosperitet dhe jetë më të mirë.

Sinqerisht i tuaji,


Ahmet Shala
Ministër

CC: znj. Justina Shiroka-Pula, Ministre, Ministria e Energjisë dhe Minierave
z. Nenad Rasiç, Ministër, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
z. Fadil Çitaku, Kryetar i Bordit të Drejtorëve, KEK Sh.A.
z. Faton Deda, Kryetar i Bordit të Drejtorëve, KOSTT Sh.A.